



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:139168
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05557274

Ac.nr.7520/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bisliraj kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Frosina Sylejmani, anëtar të kolegjit, çështjen juridike kontestimore të paditësit A. E. (V.) nga fshati R., komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson me autorizim M. H. avokate në Viti, kundër të paditurit I. E. (Z.) nga fshati R., Komuna e Vitisë, të cilin me autorizim e përfaqëson B. I. avokat në Gjilan, me objekt të kontestit pengim posedimi, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.361/2023 i datës 24.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 08.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit A. E. (V.) nga fshati R. komuna e Vitisë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.361/2023 i datës 24.10.2023, VERTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar, C.nr.361/2023 i datës 24.10.2023, ka vendosur: I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit A. E. (V.) nga fshati R. Komuna e Vitisë, kundër të paditurit I. E. (Zaim) nga R. me pretendimin se i padituri e ka penguar paditësin, në shfrytëzimin e qetë dhe të lirë të ngastrës kadastrale nr.7....-0 me sipërfaqe prej m², në zonën kadastrale R.. II. DETYROHET paditësi A. E., që t'ia kompensojë të paditurit I. E. shpenzimet e procedurës në shumë prej 509 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën pasojën e ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktvendimi paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të: shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që aktvendimin e atakuar ta ndryshojë dhe të aprovohet kërkesë padia e paditësit si e bazuar apo të njëjtin ta anulojë dhe lëndën ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

I padituri nuk ka parashtruar përgjigje në ankesën e paditësit edhe pse i njëjti me kohë e ka pranuar ankesën e paditësit.

-Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi A. E. (V.) nga fshati R. komuna e Vitisë, më datë 21.06.2023, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për pengim posedimi kundër të paditurit I. E. (V.) nga fshati R., komuna e Vitisë, me kërkesë të parashtruar si në padinë e paditësit të parashtruar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesor, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktvendimin e ankimuar C.nr.361/2023 i datës 24.10.2023, me të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesë padinë e paditësit duke vendosur konkretisht si në dispozitivin e aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se: Gjykata provat e administruara i ka çmuar dhe vlerësuar veç e veç, por edhe si tërësi bazuar në nenin 8 të LPK-së, duke konstatuar se: Me leximin e certifikatës së pronës nr.....5/2023, e datës 20.06.2023, në emër të paditësit A. E. (V.), si dhe kopja e planit me numër dhe datë të njëjtë, gjykata vërteton se pronar juridik i ngastrës kontestuese nr.....-0, ZK R., është paditësi A.. E.. Me shikimin dhe leximin e ekspertizës kadastrale të datës 19.09.2023, e nxjerrë nga eksperti gjyqësor gjeodet T. N., gjykata vërteton gjendjen faktike të ngastrës-0, ZK R., e cila në terren ishte e mbjellur me bari, por kishte edhe bimë tjera, por për dallim nga ngastrat që përkufizoheshin me këtë, vërehej se deri diku mirëmbahej nga i padituri.

Më tej ka arsyetuar se: Bindjen e gjykatës se i padituri nuk e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e qetë të sipërfaqes prej m², nga ngastra nr.....-0, e forcojnë dëshmitë e dëshmitarëve, të paraqitura gjatë seancës kryesore, të cilët me radhë dëshmuan se asnjëherë paditësin nuk e kanë vërejtur të ketë punuar, apo të jetë prezent ndonjëherë në ngastrën kontestuese. Si të vërtetohet pretendimi i paditësit se është penguar në shfrytëzimin e qetë të ngastrës, kur ai asnjëherë nuk e kishte në shfrytëzim ngastrën, me çfarëdo veprimi faktik të tij. Madje edhe dëshmitari i vetë paditësit J. E. nga R., ka deklaruar se me paditësin A. E janë djemtë të axhës por edhe baxhanakë, por ka thënë se prona kontestuese edhe pse është në pronësi juridike të A. si paditës, asnjëherë A. nuk e kam parë duke punuar diçka në atë arë, por e kam pa bacën Ibrahim duke e kositur barin, ndërsa tjetër kënd nuk e kam pa asnjëherë, duke shtuar se herën e fundit e kam pa në muajin qershor të këtij viti. Edhe dëshmitari A. H., kishte thënë se tri vitet e fundit barin në atë arë e kam lidh me presën time, por me lejen e I. E., i cili sa herë më ka ftuar me telefon. Këto dëshmi janë të mjaftueshme për ta nxjerr konkludimin e saktë, se paditësi asnjëherë nuk e kishte

pushtetin faktik në këtë pronë kontestuese, së paku në tri vitet e fundit, apo edhe më tepër. Natyrisht, gjykata vlerëson se dëshmitë e dëshmitarëve, ishin dominuese në raport me provat e tjera, për të vendosur gjykata refuzimin e kërkesës së paditësit.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke u bazuar në konstatimet dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit, së paku të periudhës së tri (3) vjeçare të para datës 20 Qershor 2023. Pra, për ta konstatuar pengim posedimin nuk është përmbushur kushti kryesor, që do të thotë se paditësi mbi 3 vite nuk ka ushtruar pushtetin faktik mbi patundshmërinë kontestuese, andaj dominuese dhe vendimtare për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit ishin dëshmitë e dëshmitarëve, të cilat ishin të njëjta dhe të ngjashme me pretendimet e palës së paditur. Ky konstatim u vërtetua në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e të pa anshëm nga gjykata, gjithnjë duke u bazuar në provat materiale të cilat u vlerësuan, por edhe dëshmitë/deklaratat e dëshmitarëve të propozuar nga vetë palët, e bënë gjykatën që ta nxjerr konkludimin e sigurt juridik, se i padituri nuk e ka penguar paditësin në shfrytëzimin e ngastrës nr.....-..., ZK R., sepse nuk ishte në pushtetin faktik të tij ngastra dhe as që ka provuar të hy në posedim të saj ndonjëherë paditësi.

Lidhur me mënyrën e vendosjes është bazuar në nenin 142, paragrafi 3 dhe nenit 480 të LPK-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës është vendosur në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e gjithashtu nuk është përfshirë as në shkeljet tjera të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë dhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë..

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i paditësit se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n) të LPK-së, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është i qartë i kuptueshëm dhe nuk është kundërthënës me arsyet e tij. Po ashtu aktvendimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, janë dhënë arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. pasi që në kontestet e pengimit të posedimit gjykata është e obliguar të provoj faktet lidhur me gjendjen e fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, ndërsa në këtë rast nga provat e administruara nuk është vërtetuar se në rastin konkret paditësi është posedues i fundit i ngastrës lëndore dhe si rezultat i kësejë nuk është vërtetuar akti i pengim posedimit në ngastrën lëndore, në mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka gjetur se i paditurit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të pengimit të posedimit të paditësit në paluajtshmërinë e tij me nr.....-0 në sipërfaqe prej m² ZK R..., pasi që edhe gjykatës së Apelit i rezultoi e njëjta gjendje faktike e vërtetuar. Me të drejtë është vërtetuar se në parcelën kontestuese posedues i fundit faktik ka qenë i padituri, i cili vazhdimisht është kujdesur për të njëjtin parcelë duke e kositur barin dhe vazhdimisht duke u kujdesur për parcelën kontestuese dhe se paditësi me asnjë provë nuk ka mundur që të vërtetojë të kundërtën, përkatësisht se i njëjti ka qenë posedues faktik i ngastrës kontestuese, fakte këto të vërtetuara nga provat që gjinden në shkresat e lëndës si dhe dëshmitë e dëshmitarëve, të cilat dëshmi janë të besueshme edhe për gjykatën e Apelit, pasi që të njëjtat janë në harmoni edhe me provat tjera që gjinden në shkresat e lëndës. Fakti se paditësi në vitin 2022 është bërë titullarë juridik i paluajtshmërisë kontestuese, nuk nënkupton se i njëjti ka hyrë edhe në posedim të kësej paluajtshmërie dhe në rastet të tillë, në kontestet nga pengimi i posedimit, gjykata është e lidhur vetëm me faktin e posedimit të fundit faktik dhe jo me bazën e posedimit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale pasi që sipas nenit 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore është përcaktuar se *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfshihet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përfshihet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrëhet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.”*. Nga vetë koncepti ligjor i mbrojtjes së posedimit, rrjedh detyrimi i gjykatës që e njëjta të provojë vetëm posedimin e fundit dhe atë pa u lëshuar në rrethana që lidhen me bazën juridike. Andaj, në rastin konkret nuk është kontestuese se paditësi është pronarë i ngastrës P-....-0 në sipërfaqe prej m² ZK Ramajan, për të cilën pretendon se është penguar në shfrytëzimin e sajë, mirëpo kontestuese ishte fakti se paditësi a ka qenë në posedim të asaj paluajtshmërie, gjë që i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë për të vërtetuar një gjendje të tillë faktike. Sipas nenit 7 par. 1 të LPK-së, i cili parasheh që *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Andaj, në rastin konkret paditësi ka dështuar të paraqes prova për të vërtetuar faktet e parashtruara në padi.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të paditësit në lidhje me atë se paditësi është pronarë juridik dhe se me regjistrimin e të drejtës së tij juridike në libra kadastral nënkupton edhe posedimin e kësej paluajtshmërie, por të njëjtat pretendime nuk i morri për bazë pasi që në rastet të tillë, posedimi dhe hyrja në posedim në një paluajtshmëri nuk varet nga regjistrimi i sajë në libra kadastral, por duhet të ushtroj pushtet faktik ndaj paluajtshmërisë në kuptim të nenin 103 të LPDTS në të cilin është paraparë se *“personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”*. Ndërsa me nenin 104 po të njëjtut ligj është paraparë se *“posedimi në një send fitohet me krijimin e pushteti faktik mbi sendin. Marrëveshja e poseduesit të mëparshëm dhe e fituesit të posedimit është e mjaftueshme për fitimin e posedimit, nëse fituesi është në*

gjendje që të ushtrojë pushtetin mbi sendin në momentin e marrëveshjes". Andaj, në rastin konkret nuk është vërtetuar se paditësi ka hyrë ndonjëherë në posedim të kësej paluajtshmërie e gjithashtu nuk ka ushtruar asnjëherë pushtetin mbi këtë paluajtshmëri edhe për kundër faktit se i njëjti është pronarë i kësej paluajtshmërie.

Janë vlerësuar edhe pretendime tjera ankimore të paditësit, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të njëjtat pretendime nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe në ankesën e paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, gjykata e shkallë së parë e ka marrë në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në dispozitat ligjore përkatësisht nenin 452.1 të LPK-së, pasi që të njëjtat shpenzime janë shpenzime të domosdoshme që janë krijuar në këtë çështje kontestimore dhe janë në harmoni me tarifat e OAK-së.

Nga të cekurat më lartë e duke u mbështetur në dispozitën e nenit 194, 208 dhe 209 parag.1 pika b) të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7520/2023 me datë 08.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj, d.v